## *AKT THEMELIMI*

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"**JULIA** " SH.P.K.

Sot, më datën 20.02.2024, **Zj. Enerjeta TAFA** e lindur në Darzezë , Shqiperi me datë 26 nentor 1972 mbajtëse e kartës së identitetit me numër H26126087W , banuese në Shqiperi, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe **Z. Sajmir BEÇA,** i lindur në Elbasan, Shqiperi me datë 20 korrik 1973, banues në Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me numër H30720083E madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **"JULIA"** Sh. P. K. si më poshtë vijon

**Neni 1**

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin **"JULIA ".**
Ortakë të kësaj shoqërie janë **Zj. Enerjeta TAFA** , **Z. Sajmir BEÇA**
Administratore e kësaj shoqërie caktohet **Zj. Enerjeta TAFA** per nje periudhe deri ne 5 vjet.
Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqëria **"JULIA "** gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "**Sh. P. K.**". Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.
Selia e shoqërisë **"JULIA "** *SH.P.K.* eshte: DURRES, Lagjja nr. 13, Rruga Pavaresia , zona kadastrale 8518, me numer pasuria 3/22 tek Ura e Dallanit, Plazh.

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

**Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitet me objekt:

- Dhenie ambjente me qira.
- Sherbim parkingu privat
- Agjensi sherbimesh te ndryshme komisionere.
- Veprimtari turistike si brenda dhe jashte vendit.
- Agjensi imobiliare.
- Bar- Restorant
- Sherbime hotelerie

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera si me poshte:

**Zj. Enerjeta TAFA** zotëruese e një kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

**Z. Sajmir BEÇA** zotërues I një kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund te jete ne para ose ne natyre ( pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta ). Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

**Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakëve të saj.

**Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

**Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

**Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organinzimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

**ORTAKET E SHOQERISE**

| **Enerjeta TAFA** | **Sajmir BEÇA** |
| --- | --- |
| Enerjeta Tafa | SAJMIR BEÇA |

Enerjeta Tafa

Digitally signed by Enerjeta Tafa
Date: 2024.02.21 12:47:24 +02'00'